



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi/i hetuari **Edmond Braha** më datë 20.06.2024 ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Verifikimi i nevojave të sigurimit dhe zëvendësimi i masës së sigurimit dhënë me vendimin nr.39, datë 14.04.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke vendosur zëvendësimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” të caktuar ndaj Edmond Braha me vendimin me nr.37, datë 10.04.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me masën e sigurimit personal “Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore” të parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale”.

2. Në përfundim të gjyqimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Flora Hajredinaj, bazuar në nenet 112, 228 e vijues, 246/6 të K.Pr.Penale, me vendimin Nr. 384, datë 17.07.2024, vendosi:

1. Shqyrtimin në seancë gjyqësore të informacionit me shkrim, mbi hetimet e kryera dhe nevojat e sigurimit për kërkuesin/të hetuarin **Edmond Braha**.
2. Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit “**arrest në burg**” të caktuar ndaj kërkuesit/të hetuarit Edmond Braha të caktuar me vendimin nr.37, datë 10.04.2024, dhe vijuar më pas me vendimin nr.39, datë 14.04.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 5(pesë) ditëve, nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Tiranë, më datë 17.07.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar